



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

Tiranë, më 2.12.2019

(Dokument parlamentar)

R A P O R T

PËR PROJEKTLIGJIN “PËR BUXHETIN E VITIT 2020”

(Shqyrtimi në parim)

I. Parathënie.

Shqyrtimi i projektligjit të buxhetit për vitin e ardhshëm është një akt i përvitshëm kushtetues i Kuvendit. Por, shqyrtimi i projektbuxhetit për vitin 2020 ka një specifikë, pasi gjatë këtij procesi ndodhi tragjedia natyrore, tërmeti i 26 nëntorit 2019, që solli humbje në njerëz, si dhe shëmbje e dëmtime të pasurive të paluajtshme në disa qarqe të vendit. Për këtë arsye, Këshilli i Ministrave vendosi situatën e jashtëzakonshme në vend dhe po ndërmerr, hap pas hapi, masat e nevojshme për financimin e dëmeve të shkaktuara nga tërmeti, si dhe minimizimin e pasojave të tij, me qëllim lehtësimin e kushteve të jetesës së personave apo familjeve në të cilat ka pasur viktima apo dëmtime banesash. Një pjesë e dëmeve do të përballohen nga buxheti i shtetit, ndaj edhe strukturat ekzekutive po punojnë për rishikimin e projektbuxhetit për vitin e ardhshëm, duke i dhënë prioritet minimizimit të pasojave të tërmetit. Për sigurimin e fondeve të nevojshme, Këshilli i Ministrave po shqyrton mundësinë e shtyrjes së investimeve në disa projekte, pa cenuar kryerjen e investimeve në projektet në vazhdim, si dhe investimet në disa sektorë me rëndësi të veçantë, si ujitja dhe mbrojtja nga përmbytjet. Ndryshimet që do të pësojë projektbuxheti, për të financuar pasojat e tërmetit, do të shqyrtohen nga Komisioni dhe do të pasqyrohen në projektbuxhet gjatë fazës nën për nën të tij.

II. Hyrje.

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në cilësinë e komisionit përgjegjës, në 10 mbledhje, të zhvilluara në datat 13, 14 (dy mbledhje), 15, 18, 19, 20, 21 e 22 nëntor, si dhe 2 dhjetor 2019, shqyrtoi në parim projektligjin “Për buxhetin e vitit 2020”.

Komisioni caktoi relator, për këtë projektligj, zotin Arben Ahmetaj. Në të gjitha mbledhjet e Komisionit ishin të pranishëm Ministrja e Financave dhe drejtues të stafit të kësaj ministrie.

Projektbuxheti, si çdo vit, u shqyrtua sipas një kalendari të posaçëm pune, të koordinuar me komisionet e tjera të Kuvendit. Komisioni shqyrtoi politikat dhe treguesit e përgjithshëm të projektbuxhetit, si dhe analizoi në detaj pjesët e veçanta të tij, si të ardhurat, shpenzimet, defiçitin buxhetor e borxhin publik. Në një mbledhje të posaçme Komisioni shqyrtoi veprimtaritë në fushën e koncesioneve dhe të partneritetit publik privat, si dhe efektet e tyre në ekonomi. Shqyrtimi në parim i projektbuxhetit u koordinua me shqyrtimin në parim të projektligjeve të paketës fiskale, për shkak të efekteve financiare përkatëse.

Për t’u njohur më në detaj dhe për të analizuar më në thellësi projektbuxhetin në disa sektorë kryesorë të ekonomisë, Komisioni zhvilloi disa seanca dëgjimore, respektivisht me Ministren e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale; Ministren e Arsimit, Sportit dhe Rinisë; si dhe Ministrin e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Gjithashtu, Komisioni zhvilloi një seancë dëgjimore me përfaqësues të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, për të marrë një informacion më të plotë mbi përdorimin e financave publike shqiptare në funksion të përsheptimit të zhvillimit të vendit, për të arritur realizimin e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm apo Axfordën 2030.

Që prej vitit 2015, projektbuxheti vjetor paraqitet si pjesë e Programit Buxhetor Afatmesëm, duke përcaktuar dhe harmonizuar politikat, prioritetet dhe treguesit për vitin e ardhshëm me ato të periudhës afatmesme 2020-2022.

Politikat, treguesit dhe objektivat e projektbuxhetit mbështeten në:

- Strategjinë e Menaxhimit të Financave Publike 2014-2020;
- Kuadrin makroekonomik e fiskal afatmesëm 2020-2022;
- Programin e Qeverisë;
- Politikat dhe prioritetet e zhvillimit të sektorëve të ndryshëm të ekonomisë;
- Ligjin për menaxhimin e sistemit buxhetor dhe aktet nënligjore përkatëse etj.

Projektbuxheti ka në themel objektivat e kuadrit makroekonomik e fiskal afatmesëm për tri vitet në vijim:

- ruajtjen dhe konsolidimin e mëtejshëm të stabilitetit makroekonomik të vendit;
- krijimin e klimës për një rritje të lartë e të qëndrueshme ekonomike;
- konvergimin sa më shpejt drejt nivelit mesatar të mirëqenies së Bashkimit Europian.

Kuadri makroekonomik e fiskal afatmesëm përcakton edhe drejtimit kryesore për realizimin e këtyre objektivave, të cilat janë:

- Targetimi i një trajktoreje rënëse të borxhit publik, duke synuar nivelin e borxhit publik neto poshtë 60 përqind të PBB në vitin 2021 dhe rreth nivelit 57% në vitin 2022;
- Mbajtja e një niveli të investimeve publike mbi nivelin e deficitit të përgjithshëm fiskal në çdo vit dhe mundësisht afër nivelit optimal prej 5 përqind të PBB;
- Harmonizimi me objektivin themelor të politikës monetare për stabilitetin e çmimeve, e cila targeton një normë inflacioni në nivelin 3 përqind dhe ankorimin e pritshmërive të tij rreth këtij niveli.
- Zbutja e deficitit të llogarisë korrente dhe përmirësimi i pozicionit të jashtëm të ekonomisë, duke tentuar rritjen graduale të nivelit të rezervave valutore dhe duke ruajtur të paktën një nivel dysheme të tyre, të mjaftueshëm për të financuar jo më pak se 4 muaj import mallrash dhe shërbimesh.

Vlerësimet dhe rekomandimet e institucioneve financiare ndërkombëtare.

Projektbuxheti mban në konsideratë vlerësimet dhe rekomandimet e institucioneve financiare ndërkombëtare, si Komisioni Europian, FMN e Banka Botërore, si dhe të agjencive ndërkombëtare që mbikqyrin ekonominë e vendit tonë. Politikat dhe treguesit e tij, si çdo vit, janë konsultuar me Fondin Monetar Ndërkombëtar.

Institucionet financiare ndërkombëtare kanë vlerësuar se ekonomia shqiptare po vijon të zhvillohet me ritme pozitive, por më të ngadalta se parashikimet, duke analizuar edhe faktorët që kanë ndikuar në këto rezultate. Ky ritëm pritet të përshpejtohet gjatë periudhës afatmesme. Përshpejtimi i rritjes ekonomike parashikohet të vijë nga rritja e investimeve publike e private, përmirësimi i shfrytëzimit të kapaciteteve prodhuese, si dhe vijimi i reformave strukturore, veçanërisht në sistemin e drejtësisë dhe sektorin financiar. Inflacioni ka qenë në rënie që prej vitit 2018, por me rritjen e ekonomisë, ai pritet të arrijë afër mesatares historike gjatë gjysmës së dytë të vitit 2021. Pavarësisht ngadalësimit të rimit të rritjes ekonomike, papunësia pësoi ulje, ndërsa punësimi dhe paga reale u rritën. Konsolidimi fiskal vijon, duke u reflektuar në reduktimin e deficitit fiskal dhe të raportit të borxhit publik ndaj PBB. Vijimi i konsolidimit fiskal, i kombinuar me përshpjetimin e rritjes ekonomike pritet të sjellin reduktimin e raportit të borxhit publik ndaj PBB në 60 përqind të PBB pas vitit 2022. Politikat e lehtësimit monetar vijnë dhe përmirësimet në portofolin e kredisë kanë filluar të ndikojnë në rritjen e kreditimit për sektorin privat. Sektori bankar është i mirëkapitalizuar dhe fitimprurës. Gjithashtu, institucionet financiare ndërkombëtare kanë evidentuar faktorët që mund të ndikojnë negativisht në realizimin e objektivave të programuara, si dhe masat që duhet të ndërmerren për zbutjen e ndikimit të tyre. Disa prej masave më të rëndësishme janë përmirësimi i administrimit të të ardhurave dhe maksimizimi i tyre, rritja e efikasitetit të shpenzimeve, përmirësimi i mjedisit të biznesit etj.

Politikat dhe treguesit e projektbuxhetit mbështeten në trendin e zhvillimit të ekonomisë së vendit në vite, zhvillimet ekonomike të deritanishme dhe ato të pritshme për vitin 2019, si dhe pritshmëritë për zhvillimin afatmesëm.

III. Baza ligjore.

Projektligji është propozuar nga Këshilli i Ministrave, mbështetur në:

- Nenet 158 dhe 159 të Kushtetutës;
- Nenin 29 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar”.

Shqyrtimi në parim i projektbuxhetit u zhvillua bazuar në nenet 78-81 të Rregullores së Kuvendit.

IV. Zhvillimet ekonomike gjatë vitit 2019.

Nga viti 2013, deri në vitin 2018, ekonomia e vendit u zhvillua me ritme pozitive dhe me një trend në rritje. Rritja ekonomike arriti nga 1 për qind në vitin 2013, në 4.1 për qind në vitin 2018.

Edhe gjatë vitit 2019, ekonomia vijoi rritjen pozitive, por me një ritëm më të ulët se vitet e mëparshme. Sipas parashikimit të Ministrisë së Financave, ritmi i rritjes reale të PBB këtë vit pritet të jetë 3-3.5 për qind.

Rritja ekonomike është gjeneruar kryesisht nga zgjerimi i kërkesës së brendshme, si rezultat i rritjes së konsumit dhe investimeve. Përmirësimi i kushteve të kreditimit dhe shpenzimet qeveritare në infrastrukturë rritën investimet dhe ritmet e rritjes ekonomike. Ndikim në rritjen e investimeve dhanë edhe zhvillimet në projektin TAP. Kontribut mjaft pozitiv dha rritja me 10 për qind e investimeve të huaja direkte. Përmirësimi i punësimit, rritja e pagave dhe kredisë konsumatore, nxitën konsumin privat, duke kontribuar pozitivisht në rritjen ekonomike. Norma e papunësisë arriti nivelin më të ulët historik, 11.4 për qind. Ritmi i rritjes së vendeve të punës u përshpejtua, duke u krijuar më shumë vende pune në sektorët e shërbimeve dhe në bujqësi. Pagat reale u rritën mesatarisht me 3.4 për qind, kryesisht në sektorët e shërbimeve (tregti, transport dhe turizëm).

Nga pikëpamja e ofertës agregate, rritja ekonomike u mbështet nga zhvillimet pozitive në sektorët e shërbimeve dhe ndërtimit.

Ngadalësimi i ritmit të rritjes ekonomike, gjatë vitit 2019, ishte rrjedhojë kryesisht e rënies së prodhimit të energjisë elektrike, për shkak të kushteve klimaterike. Gjithashtu, kontribut negativ

dhanë mbyllja e aktivitetit të lojërave të fatit, si dhe përfundimi i punimeve në projektin e gazsjellësit TAP. Ndikim negativ pati edhe reduktimi i eksportit neto të mallrave, si rezultat kryesisht i rënies së prodhimit të energjisë elektrike dhe stanjacionit të rritjes ekonomike në vendet partnere tregtare.

Megjithatë, faktorët që kanë sjellë ngadalësimin e rritjes ekonomike konsiderohen të luhatsëm dhe të përkohshëm. Në rritjen ekonomike për këtë vit ndikojnë edhe tregues të tjerë themelorë të ekonomisë, si vijimi i performancës pozitive në tregun e punës, perceptimi pozitiv i bizneseve dhe konsumatorëve për perspektivën e ekonomisë sonë, forcimi i stabilitetit financiar dhe përshejtimi i kreditimit të ekonomisë, forcimi i pozicionit të jashtëm të ekonomisë dhe përmirësimi i bilancit të pagesave, thellimi i konsolidimit fiskal dhe forcimi i qëndrueshmërisë së financave publike. Duke analizuar tërësinë e faktorëve që ndikojnë në rritjen ekonomike, parashikimet janë që ajo të përshejtohet në periudhën afatmesme.

Edhe gjatë vitit 2019 vijon politika e konsolidimit fiskal, e cila shprehet nëpërmjet treguesve si më poshtë:

- Defiçiti buxhetor parashikohet të jetë nën 2 për qind të PBB;
- Balanca primare fiskale vijon të jetë pozitive (0.2 për qind e PBB);
- Balanca korrente fiskale vijon të jetë pozitive (2.8 për qind e PBB), pra më e lartë se defiçiti buxhetor (i cili është -1.9 për qind e PBB), duke qenë në përputhje me rregullin fiskal të përcaktuar në ligjin për menaxhimin e sistemit buxhetor.
- Borxhi publik parashikohet të jetë në rënie (nga 67.9 për qind e PBB në vitin 2018, në 65.5 për qind të PBB në vitin 2019). Borxhi publik neto, për vitin 2019, pritet të jetë rreth 64 për qind e PBB, ndërsa në periudhën afatmesme parashikohet të jetë në përputhje me objektivat e kuadrit makroekonomik e fiskal afatmesëm: nën 60 për qind të PBB në vitin 2021 dhe 57 për qind e PBB në vitin 2022.

Norma mesatare e inflacionit u reduktua nga 2 për qind në vitet 2017 dhe 2018, në 1.5 për qind në vitin 2019. Faktorët kryesorë që ndikuan në këtë rënie janë niveli i ulët i inflacionit të importuar nga vendet partnere tregtare dhe mbiçmimi i lekut. Gjithashtu, presionet e brendshme të inflacionit ishin të dobëta, për shkak të vijimit të shfrytëzimit jo të plotë të kapaciteteve prodhuese. Banka e Shqipërisë, në përputhje me objektivin për ruajtjen e stabilitetit të çmimeve, dhe për të zvogëluar ndikimin e mbiçmimit të lekut në çmimet e brendshme, mbajti normën bazë të interesit në nivelin më të ulët historik prej 1 për qind, që nga qershori i vitit 2008. Kjo politikë u transmetua në yield-et e letrave me vlerë afatshkurtra të Qeverisë, si dhe normat e interesit të depozitave dhe kredive. Lehtësimi monetar dhe përmirësimet në portofolin e kredisë filluan të ndikojnë në rritjen e

kreditimit të sektorit privat. Megjithatë, kreditimi për bizneset është ende i kufizuar dhe duhet të stimulohet nga një gamë më e gjerë e instrumenteve të financimit.

Të ardhurat e përgjithshme të buxhetit, për vitin 2019, u realizuan në masën 97.3 për qind në krahasim me planin, me një mosrealizim prej 13.3 miliardë lekësh. Në krahasim me një vit më parë, këto të ardhura vlerësohet të rriten me 5.2 pikë përqindje. Sipas vlerësimeve të Ministrisë së Financave, të ardhurat e përgjithshme të buxhetit, në vitin 2019, përbëjnë 27.8 për qind të PBB, duke u rritur me 0.2 pikë përqindje në krahasim me një vit më parë. Në nivelin e të ardhurave të realizuara për vitin 2019 ndikuan negativisht norma më e ulët e rritjes së PBB dhe përsheptimi i pagesave të detyrimeve të prapambetura të rimbursimit të TVSH-së. Rritja e pagave dhe përpjekjet për të ulur informalitetin mbështetën rritjen e të ardhurave nga tatimi mbi të ardhurat personale dhe kontributet e sigurimeve shoqërore.

Shpenzimet e përgjithshme të buxhetit, për vitin 2019, parashikohet të realizohen në masën 97.4 për qind, me një mosrealizim prej 13.3 miliardë lekësh në krahasim me planin. Në krahasim me një vit më parë, këto shpenzime u rritën me 25.7 miliardë lekë ose 5.1 pikë përqindje. Këto shpenzime përbëjnë 29.7 për qind të PBB, nga 29.2 për qind që ishin një vit më parë.

Ajo që bie në sy lidhur me shpenzimet buxhetore, është rritja e ndjeshme e investimeve publike, të cilat në krahasim me një vit më parë, vlerësohet të rriten me rreth 3 miliardë lekë ose 3.7 pikë përqindje. Në krahasim me planin, shpenzimet kapitale janë realizuar në masën 92.3 për qind, me një mosrealizim prej 6.7 miliardë lekësh. Këto shpenzime përbëjnë 4.7 për qind të PBB, nga 4.8 për qind e PBB që ishin një vit më parë. Rritja e shpenzimeve kapitale, në krahasim me një vit më parë, vlerësohet të arrihet si në investimet me financim të brendshëm, ashtu edhe në ato me financim të huaj.

Shpenzimet korrente, në vitin 2019, vlerësohet të jenë rreth 21 miliardë lekë ose 4.9 pikë përqindje më të larta se një vit më parë. Në krahasim me nivelin e planifikuar, këto shpenzime janë realizuar në masën 99.3 për qind, me një mosrealizim prej 3.2 miliardë lekësh.

V. Diskutimi në Komision.

Relatori i projektligjit paraqiti një analizë të detajuar të projektbuxhetit në parim, si në tërësi, ashtu edhe për pjesët e veçanta të tij. Gjithashtu, në mbledhjet e Komisionit paraqitën prezantime dhe iu përgjigjën pyetjeve të deputetëve Ministrja e Financave dhe drejtuesit e tjerë të kësaj ministrie, si dhe përfaqësuesit e ministrive dhe institucioneve të ftuara për t'u dëgjuar.


Karakteristikat kryesore të projektbuxhetit për vitin 2020 dhe periudhën afatmesme.

Deputetët e mazhorancës vunë theksin në karakteristikat kryesore të projektbuxhetit për vitin 2020 dhe periudhën afatmesme 2020-2022, si më poshtë:

1. Thellimi i konsolidimit fiskal.

Tipari kryesor i projektbuxhetit për vitin 2020 dhe për periudhën afatmesme 2020-2022 është vijimi dhe thellimi i mëtejshëm i konsolidimit fiskal. Kjo vërehet në parashikimin e treguesve të defiçitit buxhetor dhe borxhit publik, si më poshtë:

- Defiçiti buxhetor parashikohet të jetë 1.6 për qind e PBB, nga 1.9 për qind e PBB që është në vitin 2019. Gjatë periudhës afatmesme defiçiti buxhetor parashikohet të reduktohet më tej, duke arritur nivelin 1.1 për qind të PBB në vitin 2022.
- Bilanci primar fiskal, për të pestin vit radhazi, parashikohet të jetë pozitiv, 0.6 për qind e PBB, duke u rritur më tej në vitet e ardhshme;
- Bilanci korrent fiskal parashikohet të jetë 3 për qind e PBB, duke arritur 3.5 për qind të PBB në vitin 2022. Kjo tregon që të ardhurat e buxhetit financojnë shpenzimet korrente dhe një pjesë të shpenzimeve kapitale. Investimet parashikohen në nivelin 5.5 për qind të PBB. Nga këto, 3 për qind e PBB financohen nga të ardhurat e buxhetit dhe pjesa tjetër nga huatë. Ky zbatim i rregullit të artë të buxhetit tregon përgjegjshmëri në menaxhimin e financave publike.
- Borxhi publik parashikohet të reduktohet gjatë periudhës afatmesme, duke zbatuar kështu një ndër rregullat kryesorë fiskalë të buxhetit dhe një ndër objektivat kryesorë të politikave makroekonomike për periudhën afatmesme. Stoku i borxhit publik, për vitin 2020, parashikohet të jetë 64.4 për qind e PBB, nga 65.5 për qind e PBB që vlerësohet të jetë për vitin 2019. Ky trend në rënie parashikohet edhe për vitet e ardhshme të periudhës afatmesme, duke arritur nivelin 59.8 për qind të PBB në vitin 2021 dhe 58.3 për qind e PBB në fund të vitit 2022. Ecuria ndër vite dhe parashikimet për borxhin publik, për periudhën afatmesme, janë si më poshtë:



Objektiv i rëndësishëm mbetet përmirësimi i vazhdueshëm i menaxhimit të borxhit. Për këtë qëllim, huamarrja e brendshme do të synojë rritjen e përdorimit të titujve afatgjatë dhe me norma interesi fikse. Huamarrja e huaj do të diversifikohet ndërmjet burimeve të ndryshme, për të siguruar optimizimin e kostos së borxhit. Një vend të rëndësishëm në huamarrjen e huaj do të zërë përdorimi i instrumentit të eurobondit, i cili do të plotësojë nevojat për financimin e tregut të kapitalit me hua, do të lehtësojë huamarrjen në tregun e brendshëm dhe do të garantojë prezencën e vendit tonë në tregjet ndërkombëtare të kapitalit.

2. Vijimi i rritjes ekonomike me ritme pozitive e të qëndrueshme.

Një ndër objektivat kryesorë të projektbuxhetit është vijimi i rritjes ekonomike të vendit, e cila shoqërohet me rritje të të ardhurave, punësimit, mbështetje më të madhe të reformave, përmirësim të shërbimeve ndaj qytetarëve dhe rritje të mirëqenies së tyre, si dhe përsheptim të procesit të integrimit në Bashkimin Europian. Rritja ekonomike, për vitin 2020, parashikohet të jetë 4.1 për qind, nga 3.4 për qind që vlerësohet të jetë në vitin 2019. Ritmi i rritjes ekonomike pritet të përshpjetohet gjatë periudhës afatmesme deri në nivelin 4.5 për qind për secilin prej viteve 2021 dhe 2022.

Rritja ekonomike do të mbështetet nga rritja e kërkesës së brendshme, nëpërmjet rritjes së konsumit dhe investimeve. Kontribut pozitiv pritet të japë edhe kërkesa e jashtme, po me nivel më të moderuar se ajo e brendshme. Rritja ekonomike parashikohet të vijë nga përmirësimi i vazhdueshëm i tregut të punës, forcimi i konsolidimit fiskal dhe qëndrueshmërisë së financave

publike, rritja e kreditimit të sektorit privat, rritja e besimit të aktorëve ekonomikë në perspektivën e ekonomisë shqiptare, si dhe qëndrueshmëria e pozicionit të jashtëm të ekonomisë.

Rritja e të ardhurave dhe përmirësimet në tregun e punës do të ndikojnë në nxitjen e konsumit privat. Në periudha afatshkurtra, rikthimi i bilancit të energjisë elektrike në nivele më pozitive do të lehtësojë bilancin tregtar dhe eksportet neto. Rritja e investimeve publike e private do të arrihet nëpërmjet vijimit të progresit në reformat strukturore, veçanërisht në sistemin e drejtësisë dhe sektorin financiar. Rritja ekonomike dhe shfrytëzimi më i plotë i kapaciteteve prodhuese pritet të rrisin inflacionin afër mesatares së tij historike në gjysmën e dytë të vitit 2021.

3. Rritja e të ardhurave të përgjithshme të buxhetit.

Të ardhurat e përgjithshme të buxhetit, për vitin 2020, parashikohen të rriten me 29.3 miliardë lekë ose 6.2 pikë përqindje në krahasim me vitin 2019. Ato përbëjnë 28 për qind të PBB, duke u rritur me 0.2 për qind të PBB në krahasim me vitin 2019.

Politikat fiskale, për vitin 2020, nuk kanë pësuar shumë ndryshime, por do të vijojnë të zbatohen politikat e miratuara vitet e fundit, duke synuar konsolidimin e sistemit tatimor. Rritja e të ardhurave parashikohet të vijë, kryesisht, nga rritja ekonomike dhe përmirësimi i administrimit fiskal. Rritja ekonomike do të sjellë zgjerimin e veprimtarisë së biznesit, rritjen e konsumit, si dhe të volumit të prodhimit, eksportit dhe importit të mallrave të taksueshme, duke ndikuar në rritjen e të ardhurave nga tatimet dhe taksat. Përmirësimi i administrimit fiskal do të arrihet nëpërmjet zbatimit të projektit të fiskalizimit, i cili do të rrisë transparencën dhe kontrollin e transaksioneve tregtare, duke ndikuar në reduktimin e informalitetit dhe evazionit fiskal.

Politikat fiskale, të ndërmarra nga Këshilli i Ministrave pas tërmetit të datës 26 nëntor 2019 dhe të shqyrtuara e miratuara nga Komisioni për Ekonominë dhe Financat synojnë t'u vijnë në ndihmë familjeve apo personave të dëmtuar nga tërmeti, si dhe rindërtimit të zonave të prekura. Këto politika janë si më poshtë:

- njohja si shpenzim i zbritshëm, deri në masën **5** % të fitimit para tatimit, të donacioneve për shkak të fatkeqësisë natyrore;
- përjashtimi, nga detyrimi i pagimit të TVSH-së, i mallrave dhe pajisjeve të projektuara posaçërisht ose të përshtatura për qëllime ushtarake, si dhe i mjeteve dhe pajisjeve që përdoren për të rindërtuar zonat e prekura nga fatkeqësitë;
- trajtimi i veçantë financiar i personave që kanë humbur familjarët e tyre, si pasojë e tërmetit;

- dhurimi i apartamenteve familjarëve të viktimave të tërmetit nga njësitë e pushtetit vendor.

4. Rritja e shpenzimeve të përgjithshme të buxhetit dhe përmirësimi i cilësisë së tyre.

Shpenzimet e përgjithshme të buxhetit, për vitin 2020, parashikohen të rriten me 25.7 miliardë lekë ose 5.1 pikë përqindje në krahasim me vitin 2019. Në raport me PBB, shpenzimet e përgjithshme mbeten në të njëjtin nivel me vitin 2019, i cili është 29.7 për qind.

Rritja e shpenzimeve të përgjithshme parashikohet të arrihet si në shpenzimet korrente, ashtu edhe në ato kapitale, si më poshtë:

- Shpenzimet korrente parashikohen të rriten me 21 miliardë lekë ose 4.9 pikë përqindje. Këto shpenzime përbëjnë rreth 84 për qind të shpenzimeve të përgjithshme.
- Shpenzimet kapitale parashikohen të rriten me 3 miliardë lekë ose 3.7 pikë përqindje. Këto shpenzime përbëjnë rreth 16 për qind të shpenzimeve të përgjithshme.

5. Rritja e investimeve publike.

Investimet publike mbeten prioritet i projektbuxhetit, për të krijuar kushtet për rritjen ekonomike, zgjerimin e veprimtarisë së biznesit, rritjen e punësimit etj. Projektbuxheti 2020 parashikon rreth 25.7 miliardë lekë ose 5.1 pikë përqindje më shumë investime publike, në krahasim me realizimin e pritshëm të vitit 2019. Prioritet edhe për vitin 2020 mbetet financimi i projekteve në vazhdim, duke synuar përfundimin e tyre brenda vitit 2021. Rritja e investimeve publike do të vijë si nga rritja e financimit të brendshëm, ashtu edhe e financimit të huaj.

Gjatë vitit 2020 parashikohen të realizohen projekte të rëndësishme të infrastrukturës rrugore, si:

- Akset rrugore nacionale: Rruga e Arbrit, Rruga Milot-Balldren, Rruga Orikum-Dukat, të cilat parashikohen të përfundojnë brenda vitit 2022;
- Financimi i pjesës dërmuese të segmenteve rrugore në vazhdim, me financim të brendshëm, të cilat do të përfundojnë brenda vitit 2022, si: Kardhiq-Delvinë, Elbasan-Banjë, By Pass Shkodër, By Pass Tepelenë, një pjesë e mirë e Unazës së Tiranës;
- Përfundimi i segmenteve rrugore me financim të huaj, brenda vitit 2021, si: By Passi i Fierit, By Passi Vlorë, Qukës-Qafë Plloçë etj.

- Reduktimi i numrit të aksidenteve me pasojë humbje jetë njerëzish dhe e numrit të pikave të zeza me 25 për qind.

6. Mbështetja e sektorëve prioritarë.

Prioritet në projektbuxhetin e vitit 2020 është mbështetja e sektorëve prioritarë: shëndetësia, arsimit, bujqësia, infrastruktura dhe reforma në drejtësi.

Sektori i shëndetësisë do të financohet me rreth 3 miliardë lekë më shumë ose 5 pikë përqindje më shumë në krahasim me buxhetin 2019. Ky buxhet do të mbështesë rikonstrukcionin e qendrave shëndetësore, rimbursimin e ilaçeve etj.

Sektori i arsimit do të financohet me 3.3 miliardë lekë më shumë në krahasim me vitin 2019. Buxheti për Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë parashikohet të rritet me 9 pikë përqindje. Mbështetje më e madhe do të jepet për rritjen e investimeve në arsimin e lartë, në kuadër të paktit për Universitetin, ofrimin e teksteve shkollore falas për nxënësit e arsimit parauniversitar nga shtresat sociale në nevojë, si dhe për trajtimin e tyre me kuotë ushqimore.

Sektori i bujqësisë do të financohet me 1.8 miliardë lekë ose 19 pikë përqindje më shumë në vitin 2020, krahasuar me vitin 2019. Prioritet në këtë sektor do t'i jepet rritjes së produktivitetit dhe konkurrueshmërisë së produkteve bujqësore e blegtorale, sigurisë ushqimore dhe zhvillimit të qëndrueshëm rural.

Reforma në drejtësi. Projektbuxheti plotëson të gjitha nevojat financiare të institucioneve të reja, të krijuara në kuadër të reformës në sistemin e drejtësisë, si KLP, KLGJ, Byroja e Hetimit dhe SPAK. Gjithashtu, ai siguron mbështetje financiare për pagat e rritura të magjistratëve dhe oficerëve të Policisë Gjyqësore.

Mbështetja e buxhetit të mbrojtjes. Gjatë vitit 2020 projektbuxheti për Ministrinë e Mbrojtjes parashikohet të rritet me 2.8 miliardë lekë në krahasim me vitin 2019. Kjo rritje synon realizimin e objektivit të ndërmarrë në kuadër të anëtarësimit të vendit tonë në NATO, që buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes të jetë 2 për qind e PBB në vitin 2022.

7. Konsolidimi i procesit të menaxhimit financiar në nivel vendor.

Mbështetja e reformës administrativo-territoriale dhe decentralizimit fiskal të pushtetit vendor është një objektiv tjetër i rëndësishëm i projektbuxhetit. Shpenzimet për pushtetin vendor parashikohet të rriten me 3.3 miliardë lekë ose 6.2 pikë përqindje, në krahasim me vitin 2019. Kjo rritje do të sigurohet si nga rritja e transfertës së pakushtëzuar për pushtetin vendor, ashtu edhe nga

rritja e të ardhurave të veta. Gjatë vitit 2020 do të vazhdojë mbështetja financiare për reformën në arsimin parashkollor, për të vendosur një skemë financimi të përshtatshme dhe efektive, që synon përmirësimin e cilësisë së shërbimeve.

Rishikimi i projektbuxhetit 2020.

Aktualisht, Këshilli i Ministrave po punon për rishikimin e projektbuxhetit të vitit të ardhshëm, për të pasqyruar efektet e dëmeve të shkaktuara nga tërmeti. Prioritet do të ketë sigurimi i fondeve për programin e rindërtimit të banesave të shembura e dëmtuara nga tërmeti. Gjithashtu, prioritetet e rëndësishme janë rindërtimi dhe restaurimi i shkollave të dëmtuara nga tërmeti, si dhe pagesa e qirasë së banimit për familjet, të cilave u janë shembur shtëpitë dhe banojnë në hotele apo mjedise me qira. Për mbulimin e këtyre financimeve, po komunikohet me institucionet përgjegjëse, për të parë mundësinë e shtyrjes së investimeve në disa projekte, pa cenuar vijimin e punimeve në projektet në vazhdim, si dhe financimin e sistemit të ujitjes dhe mbrojtjes nga përmbytja. Një pjesë e dëmeve do të përballohen nga donatorët brenda e jashtë vendit. Komisioni për Ekonominë dhe Financat do të shqyrtojë propozimet e Këshillit të Ministrave për financimin e dëmeve të shkaktuara nga tërmeti gjatë fazës së shqyrtimit nen për nen të projektbuxhetit, duke pasqyruar ndryshimet e nevojshme në projektbuxhet.

Shqyrtimi i raporteve të komisioneve të tjera të Kuvendit.

Komisioni për Ekonominë dhe Financat u njoh me raportet e komisioneve të tjera të Kuvendit për projektbuxhetin e ministrive dhe institucioneve të fushës që ato mbulojnë. Në këto raporte theksohet se të gjitha komisionet e kanë miratuar në parim projektbuxhetin me votat pro të mazhorancës dhe votat kundër të opozitës, duke dhënë edhe argumentet përkatëse. Disa komisione kanë paraqitur kërkesa për shtesë shpenzimesh në disa institucione buxhetore. Të gjitha kërkesat që do të paraqiten nga komisionet e tjera të Kuvendit për rishikimin e projektbuxhetit do të shqyrtohen nga Komisioni për Ekonominë dhe Financat gjatë fazës së shqyrtimit nen për nen të tij.

Fokusimi tek objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm.

Mbështetur në prezantimin dhe propozimet e përfaqësuesve të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, Komisioni vlerëson se projektbuxheti duhet të fokusohet në politikat, prioritetet dhe masat për përsheptimin e zhvillimit të vendit, duke synuar arritjen e objektiveve të zhvillimit të qëndrueshëm apo Axfordës 2030. Për të arritur këto objektiva, financat publike të vendit duhet të orientohen në këto drejtime kryesore:

Së pari, fokusimi tek programet në fushën e shtetit të së drejtës dhe mirëqeverisjes.

Për këtë është e nevojshme të rritet aksesin në drejtësi, përmes investimeve më të mëdha në ndihmën ligjore falas, financimeve më të mëdha për institucionet e pavarura të të drejtave të njeriut, si dhe

rritjes së mbështetjes ndaj OJF-ve që mbrojnë komunitetet. Gjithashtu, nevojitet mbështetje më e madhe me burime financiare e pushtetit vendor, me qëllim realizimin e funksioneve të tij në shërbim të qytetarëve.

Së dyti, fokusimi tek ekonomia e gjelbër, gjithëpërfshirëse.

Kjo kërkon nxitjen e investimeve të qëndrueshme, që sjellin rritje të punësimit dhe mbrojtje të mjedisit. Duhet të fokusohemi më shumë tek energjia e rinovueshme, si energjia diellore dhe ajo e erës. Nxitja e punësimit dhe mbështetja e personave me aftësi të kufizuara, përfshirja më e madhe e grave në punësim janë faktorë të tjerë të rëndësishëm në këtë drejtim.

Së treti, rritja e investimeve në kapitalin njerëzor dhe social.

Kjo kërkon rritjen e mbështetjes financiare në arsim, shëndetësi, mbrojtje sociale, si dhe mbështetjen e azilkërkuesve në Shqipëri.

VI. Konkluzion.

Projektbuxheti i vitit 2020 parashikon thellim të konsolidimit fiskal, vijim të rritjes ekonomike me ritme pozitive e të qëndrueshme, rritje të të ardhurave dhe shpenzimeve të buxhetit, zgjerim dhe përmirësim cilësor të investimeve publike, si dhe mbështetje të sektorëve prioritarë të ekonomisë. Rishikimi i tij gjatë fazës së shqyrtimit nen për nen, si nga Komisioni për Ekonominë dhe Financat, ashtu edhe nga të gjitha komisionet e tjera të Kuvendit do të fokusohet kryesisht tek financimi i dëmeve të tërmetit.

VII. Përfundim.

Mbështetur në argumentet e sipërcituara, Komisioni e miratoi projektligjin “Për buxhetin e vitit 2020” me shumicë votash. Deputetët e opozitës votuan kundër projektligjit.

KRYETARI

Arben AHMETAJ



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Komisioni për Ekonominë dhe Financat

Tiranë, më 13.12.2019

Dokument parlamentar

(Komision përgjegjës)

R A P O R T

PËR PROJEKTLIGJIN “PËR BUXHETIN E VITIT 2019”

(shqyrtimi nen për nen dhe në tërësi)

- ***Hyrje.***

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në cilësinë e Komisionit përgjegjës, në mbledhjen e datës 13 dhjetor 2019, shqyrtoi nen për nen dhe në tërësi projektligjin “Për buxhetin e vitit 2020”, propozuar nga Këshilli i Ministrave. Procedura e shqyrtimit të projektbuxhetit nen për nen u mbështet në nenet 32-39 dhe 83 të Rregullores së Kuvendit.

Relator për këtë projektligj është z. Arben Ahmetaj.

Shqyrtimi nen për nen i projektbuxhetit u zhvillua pas miratimit në parim të tij, në seancën plenare të datës 5 dhjetor 2019. Gjatë këtij procesi Komisioni mori në konsideratë edhe projektligjet e paketës fiskale, së bashku me ndryshimet e miratuara në Komision, për shkak të efekteve financiare përkatëse.

Në mbledhjen e Komisionit ishin të pranishëm Zëvendësministri i Financave dhe drejtues e përfaqësues të stafit të kësaj ministrie, të cilët dhanë informacionet përkatëse për pyetjet e deputetëve.

- ***Diskutimi në Komision.***

Komisioni për Ekonominë dhe Financat shqyrtoi raportet e komisioneve të tjera të përhershme të Kuvendit për vlerësimin nen për nen dhe në tërësi të projektligjit “Për buxhetin e vitit 2020”. Në secilin prej raporteve të Komisioneve theksohet se projektbuxheti është miratuar, nen për nen dhe në tërësi, me shumicë votash. Disa komisione kanë propozuar ndryshime në shpenzimet e parashikuara për vitin 2020 për ministrinë dhe institucionet e fushës që ato mbulojnë, duke dhënë edhe argumentet mbështetëse.

Gjithashtu, Komisionit shqyrtoi disa propozime të argumentuara, për ndryshime në projektbuxhet, nga Byroja e Kuvendit, Kontrolli i Lartë i Shtetit, Prokuroria e Përgjithshme etj.

Relatori i projektligjit theksoi se, duke u nisur nga situata aktuale, e cila kërkon marrjen e masave financiare për përballimin e dëmeve të tërmetit të nëntorit të këtij viti, projektbuxheti do të kërkojë ndryshime të rëndësishme, ku vendin kryesor e zë programi i rindërtimit. Fondi për këtë program parashikohet të jetë 20 miliardë lekë për vitin 2020, nga të cilat 13 miliardë lekë do të financohen nga buxheti i shtetit dhe 7 miliardë lekë do të financohen nga donatorët. Ky fond mund të rritet gjatë vitit, në rast se rriten donacionet që kanë qëllim rindërtimin e vendit. Fondi do të trashëgohet në vitin pasardhës, me qëllim mbulimin e të gjitha kostove të mundshme të pasojave të tërmetit. Në kuadër të masave financiare të ndërmarra për shkak të tërmetit, në projektbuxhetin e vitit 2020 parashikohet, gjithashtu, të shtohet edhe një fond prej 1 miliardë lekësh në programin “Strehimi”, i cili do të gjenerohet nga reduktimi, në të njëjtën masë, i shpenzimeve kapitale për projekte të reja.

Të gjitha propozimet e paraqitura nga komisionet dhe institucionet buxhetore u konsultuan me përfaqësuesit e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, për të parë mundësinë e mbulimit me burimet e nevojshme buxhetore.

Në përfundim të këtij procesi, Komisioni miratoi një pjesë të propozimeve. Për propozimet e paplotësuara, Komisioni rekomandoi që nevojat më të domosdoshme të përballohen nga fondi i parashikuar në projektbuxhet, duke rritur efektivitetin e përdorimit të fondeve në dispozicion, me qëllim që t’i jepet prioritet programit të rindërtimit.

Komisioni miratoi disa ndryshime në projektligjin “Për buxhetin e vitit 2020”, si më poshtë:

A) Ndryshime në nenet e projektligjit.

1. Kudo në projektligj, fjalët Ministri/Ministria i/e Financave dhe Ekonomisë zëvendësohen me fjalët “ministri/ministria përgjegjës/përgjegjëse për financat”.

2. Në nenin 19, rreshti i dytë, fjalët “vlera indikative” zëvendësohen me fjalët “vlera orientuese”.

3. Pas nenit 6, shtohet neni 6/1 me këtë përmbajtje:

“Programi i rindërtimit

Fondi i Rindërtimit prej 20 miliardë lekësh, cili përdoret për përballimin e pasojave të tërmetit të vitit 2019, përbëhet nga:

- Grante 7 miliardë lekë;
- Shpenzime të buxhetit të shtetit 13 miliardë lekë.

Fondi prej 20 miliardë lekësh tejkalon kufijtë e shpenzimeve buxhetore për çdo ministri dhe program buxhetor, të miratuara në tabelën 1 të nenit 10 të këtij ligji.

Çdo e ardhur në formë granti, me destinacion përballimin e pasojave të tërmetit, mbi tavanin prej 7 miliardë lekësh, rrit në të njëjtën masë të ardhurat dhe shpenzimet e Fondit të Rindërtimit, duke shtuar kufijtë e përcaktuar në nenet 1, 2, 8 dhe 10, si dhe në tabelat 1 dhe 4 të nenit 10 të këtij ligji.

Në fund të vitit buxhetor, fondet e pashpenzuara trashëgohen në vitin pasardhës dhe përdoren për të njëjtin qëllim.

Mënyra e përdorimit të Fondit të Rindërtimit, programet buxhetore ku do të alokohet, si dhe institucionet dhe agjencitë zbatuese të tij, përcaktohen nga Këshilli i Ministrave.” .

4. Në nenet e projektligjit reflektohen, gjithashtu, të gjitha ndryshimet e propozuara në tabelat dhe anekset e tij.

B) Në tabelat dhe anekset e projektligjit bëhen këto ndryshime:

I. Krijohet Fondi i Rindërtimit në vlerën 20 miliardë lekë.

II. Rialokohen shpenzimet kapitale prej 6.2 miliardë lekësh nga projektet e reja, në projektet prioritare në vazhdim dhe në ato të lidhura me emergjencën, si më poshtë:

1. Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë i shtohen shpenzimet në vlerën 3 miliardë lekë, nga të cilat:

- 2.5 miliardë lekë shpenzime kapitale;
- 0.5 miliardë lekë shpenzime korrente.

2. Fondit të Zhvillimit Shqiptar i shtohen shpenzimet kapitale me 1 miliardë lekë.

3. Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural i shtohen shpenzimet kapitale me 0.5 miliardë lekë, me destinacion mirëmbajtjen e digave.

4. Ministrisë së Financave i shtohen shpenzimet korrente, në programin “Strehimi”, në vlerën 1 miliardë lekë.

III. Bëhen disa rialokime midis programeve të shpenzimeve korrente dhe kapitale, si më poshtë:

- **Shërbimit Informativ Shtetëror** i shtohen 120 milionë lekë shpenzimet korrente për mirëmbajtjen e sistemit “PALANTIR”, i cili është një program amerikan që përdoret nga

agjencitë e inteligjencës në luftën kundër terrorizmit dhe analizën e të dhënave që mblidhen në agjenci.

- **Ministrisë së Mbrojtjes** i zbriten shpenzimet korrente me të njëjtën vlerë.

Bëhen disa rialokime të tjera sipas tabelave përkatëse bashkëlidhur.

IV. Bëhen disa shtesa në institucionet si më poshtë:

1. Në projektbuxhetin e Kuvendit bëhen këto ndryshime:

- Shtohen 2 punonjës në organikën e Administratës së Kuvendit;
- Shtohen shpenzimet korrente në vlerën 74 milionë lekë;
- Shtohen shpenzimet kapitale në vlerën 180 milionë lekë.

Detajimi i shpenzimeve të Kuvendit në programe e zëra bëhet sipas tabelës bashkëlidhur.

2. Në Prokurorinë e Përgjithshme shtohen 60 punonjës në organikë.

3. Në programin “Shërbimi për diasporën” bëhen këto ndryshime:

Së pari:

- Pakësohen shpenzimet kapitale me financim të huaj në vlerën 19 milionë lekë;
- Shtohen shpenzimet kapitale me financim të brendshëm në të njëjtën vlerë.

Së dyti, shtohen shpenzimet totale me 17.3 milionë lekë, nga të cilat:

- Shtohen shpenzimet e personelit me 5.9 milionë lekë;
- Shtohen shpenzimet korrente me 14.9 milionë lekë;
- Reduktohen shpenzimet kapitale me 3.5 milionë lekë;

Së treti, detajohet buxheti i Shërbimit për Diasporën sipas institucioneve respektive, sipas tabelës bashkëlidhur.

4. Në buxhetin vendor bëhen këto ndryshime:

- Në tabelën 3, në kolonën “Shtesë nga Kuvendi”:
 - shtohet transferta e pakushtëzuar në disa bashki me 200 milionë lekë sipas tabelës bashkëlidhur.
 - shtohet transferta specifike për shpenzimet kapitale për rrugët me 200 milionë lekë, sipas tabelës bashkëlidhur.
- Në tabelën 3, në kolonën “Mbrojtja sociale” shtohen shpenzimet në vlerën 26 milionë lekë për Qendrën Sociale “Horizont”, të cilat i zbriten Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Ky ndryshim të pasqyrohet në Aneksin 4 të projektligjit.

5. Në Kontrollin e Lartë të Shtetit bëhen këto ndryshime:

- Shtohen 7 punonjës në organikë;
- Shtohen shpenzimet e personelit me 7 milionë lekë;
- Shtohen shpenzimet kapitale me 20 milionë lekë, të cilat do të përdoren për mbështetjen e veprimtarisë audituese me teknologji informacioni dhe mjete të tjera të nevojshme.

6. Në Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale shtohen 2 punonjës në organikë.

7. Në Arkivin e Shtetit shtohen shpenzimet kapitale me 20 milionë lekë.

Totali i shpenzimeve rritet me 26 218.3 milionë lekë.

V. Burimet:

Rritja e totalit të shpenzimeve të buxhetit me 26 218.3 milionë lekë do të mbulohet nga rritja e të ardhurave nga grantet dhe e defiçitit buxhetor, si dhe reduktimi i shpenzimeve korrente e kapitale, në vlerat e mëposhtme:

(në milionë lekë)

Burimet:	26,218.3
Te ardhurat nga ndihmat (grantet)	7,000
Deficiti buxhetor	10,400
Shpenzime korrente gjithsej	2,400
Nga të cilat:	
Ministria e Financave dhe Ekonomise	195
Ministria e Arsimit, Rinise dhe Sporteve	310
Ministria e Shendetesise dhe Mbrojtjes Sociale	246
Ministria e Drejtesise	120
Ministria per Europen dhe Punet e Jashtme	207
Ministria e Brendshme	150
Ministria e Mjedisit	20
AKSHI	140
Ministria e Infrastruktures dhe Energjise	340
Kuvendi	17
Ministria e Mbrojtjes	300
Ministria e Bujqesise dhe Zhvillimit Rural	180
Prokuroria e Pergjithshme	20
Keshilli i Larte Gjyqesor	50
Gjykata Kushtetuese	12

Agjencia Telegrafike Shqiptare	7
INSTAT	81
Shkolla e Magjistratures	5
Shpenzimet Kapitale gjithsej	6,418
Nga të cilat:	
Arsimi Universitar	200
Kryeministria	10
Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	238
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	2,945
Ministria e Financave dhe Ekonomise	227
Ministria e Arsimit, Rinise dhe Sporteve	245
Ministria e Kuturës	163
Ministra e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	78
Ministria e Drejtësisë	71
Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme	13
Ministria e Brendshme	109
Ministria e Mbrojtjes	370
Shërbimi Informativ i Shtetit	15
KLSH	8
Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	144
ZABGJ/KLGJ	20
Gjykata Kushtetuese	2
Shkolla e Magjistratures	57
Fondi i Zhvillimit Shqiptar	1,364
Avokati I Popullit	1
Komisioneri për Mbrojtjen e Shërbimit Civil	1
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	1
ILDKPI	1
Institucione te tjera qeveritare	134
Autoriteti për të Drejtën e Informimit	1

VI. Komisioni propozon që të gjitha ndryshimet e mësipërme të reflektohen në tabelat dhe nenet e projektligjit.

- ***Konkluzion.***

Ndryshimet e propozuara nga Komisioni për Ekonominë dhe Financat, të cilat mbajnë në konsideratë edhe propozimet e komisioneve të tjera të Kuvendit, nuk prekin objektivin kryesor të projektbuxhetit për vijimin e konsolidimit fiskal të vendit. Bilanci primar do të vijojë të mbetet në terma pozitive. Këto ndryshime orientohen kryesisht në drejtim të Fondit për Rindërtimin e Vëndit, për shkak të tërmetit të muajit nëntor. Shpenzimet buxhetore shtohen me 26.2 miliardë lekë, nga të cilat 20 miliardë lekë ose mbi 76 për qind e zenë shpenzimet për rindërtimin e vendit. Financimi i tyre do të mbulohet nga buxheti i shtetit dhe donatorët. Financimi nga buxheti i shtetit do të realizohet, kryesisht, nëpërmjet shtyrjes së fillimit të punimeve në disa projekte të reja.

Pjesa tjetër e ndryshimeve orientohet, kryesisht drejt vijimit të investimeve në disa projekte të rëndësishme për ekonominë e vendit, mbështetjen e funksionimit të institucioneve me teknologjinë e informacionit të nevojshme, si dhe mbështetjen sociale të shtresave në nevojë. Ndryshimet nuk prekin funksionimin e sistemit shëndetësor.

- ***Përfundim.***

Në përfundim të diskutimit, Komisioni e miratoi projektligjin “Për buxhetin e vitit 2020”, nen për nen dhe në tërësi, me ndryshimet e mësipërme, me shumicë votash. Deputetët e opozitës votuan kundër projektligjit.

KRYETARI

Arben AHMETAJ

TABELA E SHITESAVE NE PROJEKTLIGJIN "PER BUXHETIN E VITIT 2020" BUXHETI I KUVENDIT

Gr	Tit	Emertimi i Institucionit Buxhetor / Kap	Emer Kapitulli	600 Pagat	601 Kontrib.e Sigurimev e Shoqeror e	602 Mallra dhe Sherbime	603 Subveci- net	604 Te Tjera Transfer. Korrente Brendshm e	605 Transfer. Korrente te Huaja	606 Transfert a per Buxhetet Familiare dhe Individet
2	1110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Admir	1 Çelje nga buxheti	0	0	62,425	0	0	0	0
2	1110		2 Financim i huaj	0	0	0	0	0	0	0
2	1110		3 Kostot lokale	0	0	0	0	0	0	0
2	1110		4 TVSH, Detyrim dog	0	0	0	0	0	0	0
2	1110		5 Nga te ardhurat e v	0	0	0	0	0	0	0
2	1120	Veprimtaria Ligjvenese	1 Çelje nga buxheti	0	0	11,575	0	0	0	0
2	1120		2 Financim i huaj	0	0	0	0	0	0	0
2	1120		3 Kostot lokale	0	0	0	0	0	0	0
2	1120		4 TVSH, Detyrim dog	0	0	0	0	0	0	0
2	1120		5 Nga te ardhurat e v	0	0	0	0	0	0	0
		Kuvendi		0	0	74,000	0	0	0	0

230	231	Totali
Shpenzime Kapitale te Patrupezu ara	Shpenzime Kapitale te Trupezuar a	Totali
0	180,000	242,425
0	0	0
0	0	0
0	0	0
0	0	0
0	0	11,575
0	0	0
0	0	0
0	0	0
0	0	0
0	180,000	254,000

Projektbuxheti 2020 për Shërbimin për Diasporën

	Institucionet	Nr. Punonj.	Shpenz personeli
I	Propozimi i Komisionit për Politikën e Jashtme:		
1	Agjencia Kombëtare e Diasporës	15	16,500
2	Fondin Shqiptar për Zhvillimin e orës		
3	Qendra e Botimeve për Diasporën	15	15,600
4	“Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët	12	17,629
	Totali Shërbimi për Diasporën	42	49,729

(në mijë lekë)

Shpenzime korrente	Shpenzim e kapitale	Totali
62,000	3,000	81,500
	54,231	54,231
24,900	16,000	56,500
8,936	3,480	30,045
95,836	76,711	222,276

Shtesa ne projektbuxhetin 2020 në disa bashki

(në milionë lekë)

Nr.	Bashkitë	Shtesa e transf se pakushtëzuar 2020
1	Rrogozhinë	25
2	Kavajë	25
3	Librazhd	25
4	Gramsh	25
5	Peqin	10
6	Prrenjas	10
7	Elbasan	20
8	Pogradec	20
9	Finiq	15
10	Lushnje	15
11	Delvinë	10
	Totali	200

Shtesa ne projektbuxhetin 2020 në disa bashki

(në milionë lekë)

Nr.	Bashkitë	Shtesa e transf se pakushtëzuar sektoriale 2020
1	Rrogozhinë	110
2	Gramsh	90
	Totali	200